



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_313\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_447\_08\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_447\_08\_10**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 02.11.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Rexhep Hajdari (shifra e konsumatorit DPR - 90024242) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 24.02.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 28.01.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 14.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë konstatuar se njehsori elektrik nuk është në gjendje të rregullt pune pasi ka frenim mekanik dhe se kanë rekomanduar që i njëjti njehsor të ndërrohet. Po ashtu i njëjti ekip ka potencuar se konsumatori është duke u ngarkuar në mënyrë paushalli.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 341306 i datës 14.08.2009
- Me datë 25.09.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 001544 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 1274228.  
**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000689 datë 25.09.2009
- Me datë 31.10.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 001544, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të falsifikuara, viti i prodhimit të njehsorit elektrik është 1997 kurse vulat të vitit 1999, nga ana e jashtme njehsori dëmtime tjera nuk ka si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 28/31 i datës 31.10.2009

- Me datë 23.11.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe regjistrimin e pajisjeve të konsumatorit.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 342222 i datës 23.11.2009
- Me datë 14.12.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP08050 në vlerë prej 1,135.59 €.  
**Provë:** Fatura DPR09HP08050 e datës 14.12.2009
- Me datë 18.01.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 28.01.2010 Departamenti për Konsumatorë në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 28.01.2010
- Me datë 24.02.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 25.08.2010 DMK në ZRRE pas analizës së lëndës së konsumatorit ka lëshuar vendimin ZRRE/DMK\_V\_447\_08\_10 duke **pranuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që duke u bazuar në analizat e cekura në vendimin e DMK-së:
  1. Të shkarkojë konsumatorin nga fatura e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthimit të humbjeve) DPR09HP08050 të datës 14.12.2009 në vlerën 1,135.59 €.
- Me datë 02.11.2010 KEK-u ka apeluar vendimin e DM në Bordin e ZRRE-së.  
**Provë:** Apeli i KEK-ut i datës 02.11.2010

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_447\_08\_10** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar dëshmi shtesë, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelin e KEK-ut dhe kërkon nga KEK-u që të mbetet në fuqi vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK\_V\_447\_08\_10**.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar